

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

Pml.nr.117/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar, Rasim Rasimi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit Xh. Sh., për shkak të veprës penale “*Kanosje*”, nga neni 181, paragrafi 2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale “*Ngacmimi*”, nga neni 182, paragrafi 1. të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.3735/23 të datës 29.12.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1DP.nr.114/2024 të datës 26.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 26.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit Xh. Sh., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.3735/23 të datës 29.12.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1DP.nr.114/2024 të datës 26.01.2024.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin P.nr.3735/23 të datës 29.12.2023, të pandehurit Xh. Sh., për shkak të veprës penale “*Kanosje*”, nga neni 181, paragrafi 2. të KPRK-së dhe veprës penale “*Ngacmimi*”, nga neni 182, paragrafi 1. të KPRK-së, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, e cila masë do t’i zgjasë deri më datën 28.02.2024. Masa e paraburgimit i është vazhduar në bazë të nenit 184, paragrafi 1., nën paragrafi 1.1. dhe 1.2., pika 1.2.3, të Kodit të Procedurës penale (KPP).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN1DP.nr.114/2024 të datës 26.01.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit Xh. Sh., avokati Visar Rrecaj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të

procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penale, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe t'i prish aktvendimet e kundërshtuara, ashtu që të pandehurit t'i ndërprehet masa e paraburgimit.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.46/2024 të datës 22.02.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1., lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit thekson se aktvendimet e atakuara janë të përfshira me shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale duke mos shqyrtuar fare ankesë dhe duke mos analizuar pretendimet ankimore, se vazhdimi i masës së paraburgimit është në kundërshtim me nenin 5 të KPRK-së për një gjykim të drejtë dhe në kohë sa më të shpejt, se paraburgimi kufizohet në 4 muaj për veprat penale të dënueshme më së shumti deri në 5 vjet burgim, ndërsa i pandehuri në këtë rast është fiks 2 muaj në paraburgim, se të dy gjykatat e instancave më të ultë kanë shkelur ligjin penal duke shkelur prezumimin e pafajësisë duke u thirrur në informatat e policisë për të kaluarën kriminale të pandehurit.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike aktakuza është ngritur në bazë të provave të cilat argumentojnë dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat ngarkohet, ndërsa a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187, paragrafi 1., nën paragrafi 1.1. të KPP-së për vazhdimin e paraburgimit.

Kjo Gjykatë i gjen si të pabazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, nga se ka bazë ligjore për vazhdimin e masës së paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1., nën paragrafi 1.2., pika 1.2.3 të KPP-së, duke pasur parasysh peshën e veprave penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet se janë kryer veprat penale, karakteristikat personale të të pandehurit dhe sjellja e tij e mëparshme, e sidomos fakti se i pandehuri në vazhdimësi e deri më datën 29.11.2023, me qëllim të ngacmimit, frikësimit dhe lëndimit, është përfshirë në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ndaj të dëmtuarës E. B., në atë mënyrë që në vazhdimësi e ka përcjell, i ka shkruar mesazhe tekstuale në telefonin e saj, e në disa raste edhe e ka sulmuar fizikisht duke kërkuar nga ajo që të krijonte lidhje me të, duke i shkaktuar të dëmtuarës ndjenjën e ankthit, frikës dhe pasigurisë, si dhe nga e kaluara tij kriminale rezulton se i njëjti edhe më parë ka kryer vepra penale të natyrave të ndryshme, e disa të natyrës së njëjtë dhe ndaj të dëmtuarës së njëjtë, rrethana këto të cilat tregojnë se po të gjendet i pandehuri në liri ekziston rreziku se do të mund të përsërit veprat penale të natyrës së njëjtë, andaj vazhdimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.117/2024, më 26.02.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetar i kolegjit,  
Afrim Shala